

# Statuti dhe Akt Themelimi

i

Shoqerise "AJNA- 2014" sh.p.k

## Kapitulli I

Ne mbeshtetje te ligjit nr.9901 date 14.04.2008, "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" dhe Ligjit nr.9723,date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Rregjistrimit" qe rregullojne marredhenjet tregtare dhe funksionimin e shoqerive.

### Themeluesi

Sot me date 28/10/2024, Une themeluesi, Defrim Fiku, i biri I Mufit , lindur me date 24.04.1970, Godvi,komuna Zerqan , Diber, i pajisur me nr.personal H00424002R, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar.

### Kren I

Objekti, emertimi,selia,rregjimi juridik,afatet

Shoqeria "AJNA-2014" sh.p.k , nepermjet ketij statuti dhe Akt themelimi, bazuar ne legjislacionin shqiptar ne fuqi , rregullon gjendjen juridike te shoqerise, marredheniet e saj me te tretet, te dhenat me rendesi per poziten juridike te ortakeve ne raport me shoqerine dhe me te tretet, organet drejtuese dhe kompetencat e tyre, organizimin dhe objektin e veprimtarise se shoqerise si dhe ceshtje te tjera per mbarevajtjen e shoqerise "AJNA-2014" sh.p.k. Cdo ceshtje qe nuk eshte e shprehur ne kete statut do te interpretohet ne perputhje me frymen e tij nisur nga parimet e mirebesimit, bashkepunimit dhe interegit reciprok te ortakeve te shoqerise

### Neni 1

1.1 Objekti i veprimtarise se shoqerise , ne perputhje me legjislacionin shqiptar do te jete:

*Punime ndertimi civile, prodhim energjie, ndertim rruges, blerje-shitje materiale ndertimi, hoteleri,mirembajtje minierash,mirembajtje hidrocentralesh,punime gipsi,mirembajtje dhe ndertime urash,shitblerje materiale tekstile,tregti mallrash industriale te ndryshme ,shitblerje materiale elektrike ,shitblerje materiale hidraulike,tregtim mallrash ushqimore dhe cdo veprimtari tregtare qe nuk eshte ne kundershtrim me legjislacionin shqiptar.*

## Neni 2

Emertimi dhe selia juridike e shoqerise

- 2.1 Shoqeria do te emertohet "AJNA-2014" sh.p.k (ne vijim "Shoqeria")
- 2.2 Selia juridike e shoqerise ndodhet ne adresen:Rruga Gjeologu,Bulqize-**Diber**
- 2.3 Shoqeria mund te krijojë filiale, zyra perfaqesimi e agjensi ne qytete te tjera te Shqiperise ose jashte vendit
- 2.4 Adresa e ortakeve ne marrredhenie me Shoqerine do te jete ajo qe rezulton e shenuar ne librin e Shoqerise.

## Neni 3

Regjimi Juridik

- 3.1 Forma juridike e shoqerise eshte shoqeri me pergjegjesi te kufizuar. Vemprimtaria e saj i nenshtrohet dispozitave te statutit, si dhe legjislacionit ne fuqi. Ligji i aplikueshem per zgjidhjen e cdo mosmarreshje eventuale qe lind gjate aktivitetit te shoqerise eshte ligji shqiptar.
- 3.2 Kompetente per zgjidhjen e mosmarreshjeve te parashikuara ne paragrafin e mesiperm eshte Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.
- 3.3 Me vendimin unanim, Ortaku .mund te ndryshojhe rregjimin juridik te Shoqerise , ne qofte se ne te ardhmen krijohen premise me te favorshme per funksionimin e saj.
- 3.4 Shoqeria gezon personalitet juridik nga data e rregjistrimit te saj ne QKB.

## Neni 4

Kohezgjatja

- 4.1 Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise eshte e pacaktuar



## KREU II

Organet drejtuese, marja e vendimeve, administrimi dhe kontrolli i shoqerise ,  
ekspertet

### Neni 5

Organet drejtuese

Organet drejtuese te Shoqerise jane:

- 1) Asambleja e Pergjithshme e cila eshte organi me i larte vendimarres
- 2) Administratori i Shoqerise, qe caktohet nga Asambleja e Pergjithshme

### Neni 6


Marja e vendimeve

6.1 Asambleja, rregullisht e thirrur dhe e perbere prej ortakeve te shoqerise, perfaqeson vullnetin e ortakeve. Vendimet e marra prej saj, per sa kohe jane te vlefshme ne perputhje me ligjin dhe me kete statut, detyrojne te gjithet anetaret e asamblese edhe pse jo te pranishem dhe jo dakord

6.2 Cdo ortak ka te drejte te marre pjese ne mbledhjen e asamblese dhe disponon nje numer votash te barabarte me pjeset e kapitalit themeltar qe ai zoteron. Cdo ortak ka te drejte te perfaqesohet nga Asambleja nga persona te trete duke u leshuar atyre prokure te posacme per cdo mbledhje te asamblese

6.3 Vendimet ne mungese te presences se ortakeve mund te merren pas konsultimit me shkrim te tyre, ne rast se te gjithet ortaket miratojne me shkrim permbajtjen e konsultimit. Ne kete rast, zbatohen procedurat e percaktuar nga ligji tregtar

6.4 Ortaket lajmerohen per zhvillimin e mbledhjes se asamblese me shkrese apo me mesazh elektronik I cili duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites jo me vone se 7 dite perpara dates se mbledhjes.



6.5 Mbledhja e asamblese mund te thirret nga Administratori i shoqerise, nga nje ose disa prej ortakeve te shoqerise qe zoterojne te pakten 5% te pjeseve te kapitalit themeltar.

6.6 Cdo mbledhje e asamblese e thirrur ne menyre te parregullt, mund te anulohet . Anullimi nuk ka vlere, ne rast se te gjithë ortaket jane te pranishem ose te perfaqesuar

## Neni 7

### Kompetencat e Asamblese se Pergjithshme

7.1 Asambleja e Pergjithshme, pervec te tjerash, eshte I vetmi organ qe vendos per:

- . Emerimin ose shkarkimin e administratoreve, eksperteve kontabel te autorizuar dhe likuiduesve
- Percaktimin e shperblimeve per administratorin , ekspertin kontabel dhe likuiduesve
- . Percaktimin e politikave tregtare te shoqerise
- Mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratorët, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise
- Miratimin e raporteve te administrimit dhe te kontrollit
- . Miratimin e llogarive vjetore, destinimin e fitimit, etj
- . Ndryshimet e statutit
- Zmadhimi ose zvogelimi i kapitalit themeltar
- Pjesetimin e kuotave dhe anulimin e tyre
- Perfaqesimin e shoqerise ne Gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve
- Riorganizimin dhe prishjen e shoqerise
- Miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese
- . Transferimin e pjeseve te kapitalit themeltar tek te tretet
- Zgjatjen e kohes se veprimtarise se shoqerise apo prishjen e saj dhe kalimin ne proces likuiditeti
- . Shnderrimi I shoqerise me pergjegjesi te kufizuar ne forma te tjera
- . Etj



## **Neni 8**

### **Kuorumi**

8.1 Asambleja e pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme ne qofte se jane te pranishem ose te perfaqesuar nga nje ose disa ortak qe zoterojne 30% te pjeseve te kapitalit themeltar. Ne rastet kur Asambleja e Pergjithshme duhet te vendose per ceshtje si: ndryshimin e statutit , zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te rregjistruar, shperndarjen e fitimeve , riorganizimi dhe prishjen e shoqerise, shitja e kuotave , ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese ortaket e shoqerise themeluese jane te gjithë te pranishem dhe vendimarrja te jete unanime

8.2 Ne qofte se Asambleja e Pergjithshme nuk realizohet per mungese kuorumi , thirret asambleja e dyte brenda 30 diteve me te njejtin rend dite. Edhe ne kete rast vendimet jane te vlefshme merren nese eshte kuorumi i nevojshem ne varesi te ceshtjes rend dite te percaktuar

8.3 Ndryshimet e statutit, transferimi i pjeseve te kapitalit themeltar tek te tretet, zmadhimi ose zvogelimi i kapitalit te rregjistruar shpemdarrja e fitimeve , riorganizimi apo prishja e shoqerise dhe kalimi ne proces likuidimi, shnderrimi ne nje forme tjeter, vendosen ne mbledhjen e asamblese vetem kur kuorumi i kerkuar perbehet nga te gjithë ortaket e shoqerise dhe vendimarrja te jete unanime

8.4 Asambleja drejtohet nga nje anetar i zgjedhur nga ortaket e pranishem. Te gjitha vendimet e Asamblese transkriptohen dhe ruhen ne rregjistra te shoqerise. Ne raste te percaktuara ne ligj, vendimet e asamblese duhen te rregjistrohen ne QKB

## **Neni 9**

### **Administratori**

9.1 Ortaket bien dakord qe Administratori i shoqerise te caktohet Z/Defrim Fiku me nr.personal H00424002R.

9.2 Afati i ketij mandati fillon me me regjistrimin e ketij Statuti ne Qendren Kombetare te rregjistrimit dhe vazhdon per pese vjet 28 tetor 2024-27 Tetor 2029 me te drejte rizgjedhjeje



## Neni 10

### Kompetencat e Administratoreve

10.1 Administratori drejton te gjitha veprimtarine e Shoqerise nga pikepamja tekniko-organizative, ka te gjitha kompetencat per te vendosur ne lidhje me aktivitetin e zakonshem dhe te perditshem te shoqerise. Administratori zbaton vendimarrjet e asamblese se pergjithshme e cila vendos ne unanimitet per drejtimin dhe organizimin e shoqerise , gezon te drejta te plota vendim marrje dhe gezon te drejta te plota, vetem ne rastet e nderhyrjes emergjente apo avari qe rrezikojne vepren gjate veprimtarise se shoqerise

10.2 Te Drejtat dhe Detyrimet e Administratoreve te shoqerise

- Te kryeje te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare te vendosura nga asambleja e pergjithshme
- Të përfaqësojnë shoqërinë tregtare vetem me vendim te ortakeve per cdo rast specifik
- Të kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- Të përgatisin dhe të nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë, të cilët ia paraqesin këshillit të administrimit për miratim, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, për t'u paraqitur më pas për miratim nga asambleja e pergjithshme
- Të krijojnë një sistem monitorimi e njoftimi të hershëm për rrethanat, që kërcënojnë ekzistencën e shoqërisë;
- Të kryejnë regjistrimet e publikimet e detyrueshme të të dhënave të shoqërisë, sipas parashikimeve të këtij ligji apo të ligjeve të tjera
- Të raportojnë përpara keshillit të administrimit për zbatimin e politikave tregtare dhe, me realizimin e veprimeve me rëndësi të veçantë, për veprimtarinë e shoqërisë
- Per te gjitha punimet e sherbimet e tjera te planifikuara me pare ne sherbime dhe mirembajtje te vepres do te veproje sipas vendimit te asamblese se pergjithshme
- Të kryejnë detyra të tjera, të përcaktuara në ligj dhe në statut



## **Neni 11**

Ekspertet kontabel te autorizuar

Ne rast se Asambleja e Pergjithshme e gjykon te arsyeshme ose nese kerkohet ne menyre te shprehur nga ligji , kontrolli ishoqerise kryhet nga nje ekspert kontabel i autorizuar. Shkarkimi i ekspertit kontabel te autorizuar vendoset me te njejta kushte si emerimi

## **KREU 3**

Mjetet e shoqerise, Kapitali, Kuotat

## **Neni 12**

KAPITALI THEMELTAR

12.1 Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 leke ( njeqind mije leke)

12.2 Kapitali perbehet nga 1 kuote ku vlere e cdo kuote eshte 100.000 leke

12.3 Kontributet e ortakeve te shoqerise ne kapitalin themeltar jane si me poshte vijon:


Z. Defrim Fiku zoterues i 100% i kuotave

## **Neni 13**

KUOTAT E KAPITALIT

13.1. Kuotat e kapitalit themeltar jane emerore dhe te transferueshme .

13.2 . Kuotat e kapitalit te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet: a) kontributet mund te transferohen me ane te dhurimit, tek nje ose disa ortake te shoqerise apo tek persona te trete, pjese te kapitalit themeltar, mund ta beje kete duke marre pelqimin paraprak te ortakeve te tjere



## **NENI 14**

### **FONDET E SHOQERISE**

14.1 Shoqeria kryen veprimtarine e saj me mjete te investuara ne fondet e saj dhe me mjete te tjera. Ajo eshte e detyruar qe vellimin e punes se saj ta ushtroje ne varesi me shume mjete te investuara ne fondin themeltar te Shoqerise dhe nga shuma e mjeteve te rezerves.

Shoqeria percakton fondet e meposhtme:

1. Fondin themeltar
2. Fondin rezerve

14.2. Per ushtrimin e veprimtarise se saj shoqeria mund te percaktoje dhe fonde te tjera

## **Neni 15**

15.1 Fondi themeltar formohet nga mjete te investuara nga ortaku dhe nga mjete te tjera ne para ose ne forme tjeter te investuara.


15.2 Shoqeria shfrytezon fondin themeltar per ushtrimin e veprimtarise se saj, per investime ne fonde te personave te tjere juridik dhe fizik si dhe per te perballuar rreziket pas shfrytezimit te mjeteve te rezerves

15.3 Gjithashtu, mund ti shfrytezoje edhe per destinacione te tjera sipas interesit te shoqerise

## **Neni 16**

### **Fondi rezerve**

Fondi rezerve i shoqerise perbehet nga nje pjese te fitimit qe shoqeria realizon gjate veprimtarise se saj. Ai percaktohet me nje vendim te vecante te asamblese se ortakeve themelues, apo fondi rezerve mund te perdoret edhe per destinacione te tjera qe jane ne perputhje me interesat e shoqerise.





## KREU IV

Viti financiar, Llogarite vjetore, Ndarja e fitimeve, Dividentet

### Neni 17

Viti financiar

17.1 Cdo vit financiar fillon me date 1 Janar e perfundon me date 31 Dhjetor

17.2 Llogaria vjetore, inventari, raportet mbi operacionet e vitit dhe eventualisht nga eksperti kontabel i autorizuar , miratohet nga asambleja me shumice e ortakeve qe zoterojne mbi  $\frac{1}{2}$  e kapitalit themeltar

17.3 Miratimi i dokumentave mbi veprimtarine vjetore behet brenda nje afati te caktuar prej 6 muajsh nga data e mbylljes se vitit financiar.

### Neni 18

Llogarite financiare

18.1. Ne fund te cdo viti kalendarik duhet te hartohet nje bilanc si dhe llogaritjen e fitimeve dhe humbjeve. Me kete duhet te ngarkohen eksperte, fitimi i shoqerise ndahet si me poshte:


18.2. 5% merren si reserve ligjore nga rezerva deri sa te jene arritur ne 20% te kapitalit themeltar,

18.3. Shuma e mbetur ndahet midis ortakeve sipas pjeseve te tyre ne shoqeri.

18.4. Forma e bilanceve dhe librave te llogarise qe do te mbaje shoqeria, percaktohet nga Asambleja e Pergjithshme.

### Neni 19

19.1 Pas miratimit te llogarive vjetore dhe evidentimi te ekzistences se fitimeve, Asambleja e Pergjithshme percakton pjesen qe u takon ortakeve ne formen e dividentit. Fitimi qe do te ndahet midis ortakve ne proporcion me pjesen e kapitalit themeltar, perbehet nga fitimi i vitit financiar, te cilet jane zbritur shumat e lena menjane per fondin reserve te domosdoshme ( 5% e fitimit te cdo viti deri sa ky fond te arrije ne vleren  $\frac{1}{10}$  e kapitalit themeltar dhe nga ana tjeter i jane zbritur ose shtuar respektivisht humbjet apo fitimet e mbartura nga vitet e meparshme.



## KREU V

Kufizimi i afatit, prishja dhe likuidimi i shoqerise,

### Neni 20

Ndryshimet e afatit

20.1 Kufizimi apo zgjatja e afatit te veprimtarise se shoqerise mund te vendoset nga asambleja e ortakeve me shumicen e ortakve qe zoterojne mbi  $\frac{3}{4}$  e kapitalit themeltar.

### Neni 21

Prishja e shoqerise

21.1. Shoqeria priset ne perputhje me kushtet e percaktuara ne kete statut, me vendim te asamblese se Ortakve me kerkesen e  $\frac{3}{4}$  te pjesemarrjes ne kapitalin themeltar.

21.2 Shkaqet e prishjes se shoqerise

a. Kur mbaron kohezgjatja e percaktuar ne themelimin e saj

b. Me vendimin e Asamblese se Pergjithshme

c. Me hapjen e procedurave te falimentimit

d. Nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per 2 vjet dhe. nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne Q.K.B


e. Me vendim Gjykate

shoqeria nuk priset kur njeri nga ortaket falimenton, behet I paafte ose vdes

### Neni 22

Likuidimi i shoqerise

22.1 Shoqeria hyn ne procesin e likuidimit qe ne momentin e prishjes se saj. Per kryerjen e ketij profesu Asambleja emeron nje ose disa likuidues te cilet I paraqesin atij raportin mbi gjendjen e aktivitetit dhe te pasivitetit te shoqerise, mbi ndjekjen e operacioneve te likuidimit dhe mbi afatin e domosdoshem te perfundimit te tyre.



22.2 Ne fund te procesit te likuidimi te Asamblese me shumicen e ortakeve qe zoterojne mbi  $\frac{3}{4}$  e kapitalit themeltar vendos mbi bilanin perfundimtar financiar, mbi aktin e rregullshmerise te punes se likuiduesit dhe mbylljes se procesit te likuidimit

22.3 Pas pagimit te kreditoreve dhe shlyetjes se pjeseve te kapitalit themeltar tek kontribuesit perkates , likuiduesi ndan kapitalet e mbetura ndermjet ortakeve ne proporcion me pjeset qe ata zoteiojne ne kapitalin themeltar dhe njofton Q.K.B per perfundimin e likuidimit dhe kerkon cregjistrimin e Shoqerise

### **NENI 23**

#### Shnderrimi i shoqerise

23.1. Shnderrimi i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar ne shoqerise aksionare mund te kryhet me miratimin e shumices se ortakeve qe zoterojne mbi  $\frac{3}{4}$  e kapitalit themeltar

23.2 Marredhenjet e brendshme ndermjet punetoreve dhe shoqerise midis tyre dhe organeve te shoqerise do te rregullohen me ane te nje rregulloreje.

### **NENI 24**


#### Interpretimet statutore

24.1 Pavlefshmeria e dispozitave te vecanta te kesaj marreveshjeje nuk e prek teresine e saj vepruese. Ne vend te dispozitave te pavlefshme ose per permbushjen e hapesirave statutore, ortaket bien dakord per nje rregullim te pershtatshem, ne perputhje me qellimin e hartimit te ketij statuti, duke ruajtur interesat e perbashketa.

24.2 Per gjithcka jo te parashikuar ne kete statut do te respektohen normat ligjore te legjislacionit shqiptar ne fuqi.

24.3 Gjykata kompetente per zgjidhjen e te gjitha mosmarrveshjeve qe mund te lindin gjate ekzistences se shoqerise ose gjate periudhes se likuidimit, ndermjet shoqerise dhe ortakve , apo ndermjet shoqerise dhe te treteve do te jete Gjykata e Rrethit Gjyqesor ,Tirane

24.4. Ky statut hartohet me 4 ekzemplare original, hyn ne fuqi ditën e nenshkrimit te ketij statuti



## NENI 25

### Dizpozitat e fundit

25.1 Per te gjitha ceshtjet qe nuk gjejne rregullim ne kete statut aplikohen dispozitat e ligjit nr.9901 date 14.04.2008 'Per tregtaret dhe shoqerite tregtare'

25.2 Per efekt te interpretimit te ketij statuti me ligj tregtar do te nenkuptohet ligji nr.9901 date 14.04.2008 'Per tregtaret dhe shoqerite tregtare' ( I ndryshuar)

25.3. Pavlefshmeria eventuale e dispozitave te vecanta te statutit nuk mund te cenojne vlefshmerine ne teresine e saj

### Ortaku themelues

Defrim Fiku

